RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në mbështetje të nenit 29 dhe nenit 37 të Ligjit për Radiotelevizionit të Kosovës, nenit 20 Ligjit Nr.06/L-021, për kontrollin e brendshëm të financave publike, nenit 34 të Statutit të RTK –së, nenit 7 të Rregullores për punën e Bordit të RTK –së, nenit 27 të Rregullores së auditimit të brendshëm, në bazë të nenit 4 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ MF– nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit të datës 24.03.2022, Bordi i RTK-së, shpall:

TH I RR J E P U B L I K E

Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Radiotelevizionit të Kosovës.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe kanë njohuri e përvojë së paku dy (2) vjeçare në njërën nga këto fusha:

- Financa;
- Kontabilitet;
- Auditim të brendshëm;
- Auditim të jashtëm;
- Menaxhim të rrezikut;
- Legjislacion; dhe
- Teknologji informative.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Një kopje të CV-së;
- Një Letër motivuese;
- Një kopje e letërnjoftimit;
- Dëshmitë e kualifikimit;
- Dëshmi që nuk kanë qenë të dënuar për vepër penale dhe që nuk është nën hetime.

Detyrat, përgjegjësitë si dhe kushtet e domosdoshme të cilat duhet të plotësohen nga ana e kandidatëve të cilët aplikojnë, duke u bazuar në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MF– nr. 01/2019 (klikoni ketu).

Kandidatët e përzgjedhur për anëtarë të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Radiotelevizionit të Kosovës, kanë mandat tre (3) vjeçar nga dita e emërimit të tyre, me mundësi riemërimi edhe për një mandat shtesë.
Kandidatëve të përzgjedhur, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës me RTK-në, në pajtim me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.3 Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, ju ofrohet Kontratë Pune për Punë dhe Detyra Specifike.

Dorëzimi i dokumentacionit të kompletuar për aplikim për angazhimin e anëtarëve të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të RTK-së, mund të bëhet duke filluar nga data 05.04.2022 deri më 19.04.2022, deri në orën 16:00.

Dokumentacionet duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në e-mail adresën: yllkaasimi@rtklive.com.

Pyetjet rreth procedurave dhe kushteve për aplikim, mund të parashtrohen përmes telefonit në: 038 242 273, mob: +38343843838 dhe përmes e-mailit të cekur më lartë.